

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Raif Fazliu, me sekretaren juridike Mejreme Uka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Z.im I.(Sh.) nga F.rr.”M.Q.” nr...xx kundër të paditurve Xh. I. (R.), nga F. rr.”A. G.” nr.xxx, djali i të ndjerit R. I. (S.), I. Sh. (Sh.), D. Sh.(Sh.), Sh.Sh.(S.) H I Sh., djali i të ndjerit Sh. I. (Sh.), të gjithë nga F. në rr.”M. Q.” dhe Sh. I. (N.), nga L., Komuna e Vitisë, djali i të ndjerit N. I. (P.), baza e kontestit padi për vërtetimin e pronësisë, vlera e kontestit 3,000 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 11.05.2017, bie këtë:

A K T G J Y K I M NË BAZË TË POHIMIT

I. MIRATOHET si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit Z. I. (Sh.) nga F... dhe **VËRTETOHET** se i njëjti është pronar i ngastrave kadastrale nr. **XXXX**, me sipërfaqe prej XXX m², e evidentuar ne emer te pronarit juridik R.. I.. Sh..., ngastra nr.**XXX**, me sipërfaqe prej XXXX m², ngastra nr.**XXX** me sipërfaqe prej XXXX m², ngastra nr.**XXX**, me sipërfaqe prej XXX m², tri ngastrat në emër të bashkëpronarëve secilit nga ¼, D.Sh. (Sh.), I. Sh. (Sh), Sh. Sh. (S.) dhe Sh.. I... (Sh....) dhe ngastra nr.**XXX**, me sipërfaqe prej XXXX m², në emër të N... I.(P.), të gjitha në zonën kadastrale V.... në bazë të shitblerjes dhe mbajtjes.

OBLIGOHEN të paditurit, Xh. I. (R.), I.Sh.(Sh), D.Sh (Sh), Sh.Sh. (Sh.) H. I. (Sh.) nga F... dhe Sh.. I... (N...), nga L..., Komuna e Vitisë, që këtë të drejtë t`ia njohin paditësit Z..I..., të përmbahen dhe ta durojnë që në bazë të këtij aktgjykimi këto ngastra t`i regjistroj në emër të vetin dhe t`i shfrytëzoj pa u penguar.

II. OBLIGOHET Zyra Komunale Kadastrale në Komunën e Vitisë, ta bëjë ndryshimin në regjistrat kadastralë në bazë të këtij aktgjykimi, 15 ditë pas plotfuqishmërisë së tij.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Ky Aktgjykim është i plotfuqishëm ditën e vendosjes me 11.05.2017.

A r s y e t i m

Paditësi Z. I. (Sh.) nga F., rr.”M.. Q.” nr.XX, vetë personalisht, në padinë dhe kërkesëpadinë e tij, të dorëzuar në gjykatë me datë XXXX, ka kërkuar nga gjykata që të vërtetoj se babai i tij tani me i ndjeri Sh..I..., i kishte blerë ngastrat kadastrale nr. XXXX, me sipërfaqe prej XXX m², e evidentuar ne emer te pronarit juridik R..I..(Sh..), ngastra nr.XXX, me sipërfaqe prej XXX m², ngastra nr.**XXXX** me sipërfaqe prej XXX m², ngastra nr.XXX me sipërfaqe prej XXX m², tri ngastrat në emër të bashkëpronarëve secilit nga ¼, D. Sh. (Sh.), I. Sh. (Sh.), Sh. Sh. (Sh.) dhe Sh. I. (Sh.) dhe ngastra nr.XXX me sipërfaqe prej XXXX m², në emër të N. I. (P.), të gjitha në zonën kadastrale V...Ky raport kontraktues mes paleve kishte ndodhur para XXXX viteve, por që bartja nuk kishte ndodhur.

Gjykata të paditurve, konform dispozitave të LPK-së, ia ka dorëzuar padinë në përgjigje, të cilët po ashtu brenda afatit ligjor kanë dhënë përgjigje në padi.

Në përgjigjen në padi të paditurit kishin deklaruar se ngastrat kadastrale të shënuara si më lartë, ia kemi shitur paditësit dhe nuk ia kontestojmë të drejten e pronësisë. Ai që nga koha kur ia kemi shitur keto ngastra, është në posedim të pa ndërprerë të tyre, pasi që na kishte paguar çmimin e kontraktuar.

Nga këto arsye të paditurit individualisht ia kishin pranuar kërkesëpadinë paditësit duke mos ia kontestuar të drejtën e pronësisë, andaj i kishin propozuar gjykatës, që në tërsi ta miratoj kërkesëpadinë e paditësit. Kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, provat materiale që ka deponuar paditësi janë relevante, andaj në tërsi e kishin pranuar kërkesën e paditësit si të bazuar.

Andaj, të paditurit i kishin propozuar gjykatës që e njëjta të bie aktgjykim në bazë të pohimit, duke hequr dorë nga e drejta e ankesës, nëse gjykata e miraton kërkesëpadinë e paditësit.

Paditësi si prova ia kishte bashkangjitur padisë certifikatat e pronës per secilën ngastër kadastrale veç e veç, të gjitha të datës XXXX të lëshuara nga Zyra Komunale Kadastrale në Viti, si dhe certifikatën e vdekjes me nr. V XXXXX, në emër të Sh.I., baba i paditësit, vërtetimin e vdekjes me nr. XXXXX, date XXXX, në emër të R. Sh. I.baba i të paditurit të parë Xh. I..

Me qenë se të paditurit e kanë pranuar në tërsi kërkesëpadinë e paditësit, por edhe provat në lëndë janë në harmoni të plotë me themelësinë e kërkesëpadisë, gjykata pa u lëshuar në shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, konform nenit 148, të LPK-së, bie këtë aktgjykim në bazë të pranimit.

Është vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI

C.nr.479/2016

Më:11.05.2017.

Gjyqtari
Raif Fazliu

UDHËZIMI PËR MJETIN JURIDIK: të paditurit kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës.